



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Patos, më 03/09/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 40,572,556.3 (dyzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të Ardhurat Lokale 2024 Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar)

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,199,791 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Fondi limit = 40,572,556.3 (dyzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekë pa TVSH.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjor nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku

bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitetin, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësaj shprehjeje, prandaj bashkëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose **20,286,278.15 lekë**
- a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohe ose **40,572,556.3 lekë**

Plotesimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore përkatëse.
- 2.3.2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

2.3.3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. **NP-1:** Punime germimi në toke “Kategoria A”.
- b. **NP-4:** Rruge, autostrada, mbikalome, hekurudha, tamvai, mero, pista aeroportuale “Kategoria A”.
- c. **NS-18:** Punime topogjeodezike “Kategoria A”.

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

- **NP-1: Punime germimi në toke** “Kategoria A”

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

- **NP-4: Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale.** “Kategoria A”

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose

të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

➤ **N.S - 18 Punime topogjeodezike“Katergoria A”**

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

➤ **NP-11: Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike “Kategoria A”**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensio nit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	<p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p> <p>Transport dheu me auto deri 2.0 km</p> <p>Germim dheu me ekskavator zinxhir 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p> <p>Transport dheu me auto deri 3.0 km</p> <p>Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.</p> <p>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km</p> <p>Germim dheu me krahe</p> <p>Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III</p>	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-4	Rrugë autostrada, ura,	<p>Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri</p> <p>Shtrese stabilizant t=10cm</p>	Kategoria A	0-20 milion lekë

	mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri		
NS-18	Punime topogjeodezike	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (per kunete) Transport dheu me auto deri 2.0 km Trotuar me 6 cm beton, me pllaka (ne forme gjashte kendore) Shtrese zhavori Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura Shtrese betoni C 7/10 per fiksime bordure Kontrabordure betoni 6x20 cm F.V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=200 mm F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri Puse kontrolli 1x1x1.5m Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 150 cm Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm Nenshtrese zhavori Struktura monolite betoni C 16/20 F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm Mbushje me cakell pas mureve F.V tub drenazhi Ø 150 mm F.V Tubo HDPE Ø200 F.V shtylle metalike per ndricim, H=7m, d=160 mm F.V krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10 F.V Ndrices LED 70Ë + panel Fotovoltaik + bateri Struktura monolite betoni C16/20 Mbushje me rere	Kategoria A	0-20 milion lekë

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| b. Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder | 1 (një) |

Për këtë duhet te paraqesë

- Kontrate pune te vlefshme,
- Diplomë,
- Librezë pune,
- si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.6 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave,

Punonjës Staf Teknik

- a. 1 (një) Teknike ndërtimi
- b. 2 (dy) Karpentier
- c. 1 (një) Elektricitist
- d. 20 (njetete) Puntore të thjeshtë

Punonjës Manovrator (shofer)

- 1 (një) punonjës automakinist
- 1 (një) punonjës eskavatoriste
- 2 (dy) punonjës buldozier
- 3 (tre) Shoferë kategoria C,

2.8.1 Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. kontratën individuale të punës të vlefshme;
- b. diplomën ose certifikatën përkatëse që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- c. dëshmi të sigurimit Teknik e vlefshme, lëshuar nga institucione të autorizuara nga /ish (IQT) ose ekuivalente, e cila duhet të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.8.2 Për punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale/Patentë Manovrimi nga DPSHTRR.)
(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist ,buldozeriste dhe shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit konstruktiv. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinier Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të ndërtimit pjesë e fushës së tij, zbatimin e projektit sipas të gjithë elementëve përkatës topografik.
- **Teknike ndërtimi** (ose ing ndërtimi në zbatim) është përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e punimeve në kantierin e ndërtimit.
- **Karponente** është përgjegjës për mbërthimin e saktë të kallëpëve, për realizimin e betonimit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Elektracisti** është përgjegjës për realizimin e saktë të punimeve të ndriçimit të rrugës me materialet dhe detajet e specifikuar në projekt.
- **Shofere** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantier dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet. Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjes do të jenë të kontraktuar.
- **Manovratore** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit në kantier dhe jashtë kantierit për kryerjen e proceseve të caktuara të punëve (psh. presa/pompa betoni, ekskavatore gërmim, mini fadroma, skrep të llojeve të ndryshme etj) të nevojshme për objektin që prokurohet. Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës do të jenë të kontraktuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën **33 (tridhjetë e tre)** personave të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar,

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Referuar kategorisë së punimeve si dhe afatit, stafi i kërkuar duhet të jetë:

- *Teknike ndërtimi* 1 (një)
- *Karpentiere* 2 (dy)
- *Elektracist* 1 (një)
- *Puntorë të thjeshtë* 20 (njëzet)
- *Eskavatorist* 1 (një)
- *Automakinist* 1 (një)
- *Buldozierist* 2 (dy)
- *Shofer* 3 (tre)
- *Drejtues Teknik* 2 (dy)

TOTALI = 33 Persona ne Staf (tridhjetë e tre).

Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplome ose dëshmi kualifikimi
- Kontrata pune
 - a) *Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës ose me vulë elektronike .*
 - b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

Ne raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listpagesën e shoqërisë.

Shënim: Argumentimi i nr. të punonjësve bëhet vetem me qellim për justifikimin e stafit të kërkuar. Ndarja sipas specialiteteve në këtë rubrike të mos merret në konsideratë në plotësimin e kriterëve të përcaktuara.

2.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	në pronësi ose me qera	Copë	3
2	Autovinc deri ne 2.5 ton	në pronësi ose me qera	Copë	1
3	Fadromë me goma	në pronësi ose me qera	Copë	1

4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qera	Copë	1
5	Eskavator 0.25 m ³ me goma	në pronësi ose me qera	Copë	1
6	Autobot uji	në pronësi ose me qera	Copë	1
7	Grejder	në pronësi ose me qera	Copë	2
8	Rul me vibrim	në pronësi ose me qera	Copë	2
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qera	Copë	1
10	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
11	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
12	Betoniere 0.5 m ³	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
13	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
14	Fabrike asfaltbetoni (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi)	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Copë	1

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
- leje qarkullimi;
- çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
- siguracion mjete (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:

- kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- leje qarkullimi;
- çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
- siguracion mjete (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet

kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeteve dhe targa e tij.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme në lidhje me stafin dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, i ndryshuar datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, të mësipërme.

Argumentim i stafit dhe mjeteve të kërkuara më sipër:

Ne objektin “**Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re**” proceset e punës klasifikohen në keto kategori:

a) Punime për mobilizimin e kantierit

Këto punime përfshijnë përgatitjen e kantierit për fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do të përcaktohen furnitorët dhe vendet e depozitimit të materialit. Do të

strukturohet organika e njerezve që do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi I hyrje daljeve te tij. Afati i parashikuar eshte 12 dite pune. Puntor te angazhuar jane 5. Makineri Kamion dhe/ose pick-up.

b) Punime per gerrim dhe me ekskavator/ kanalizimi i ujërave

- **Volumi i punimeve** **1,145 m³.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **114.5 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.1 op/m³.**

Këto punime përfshijnë heqjen e shtresave ekzistuese apo materialeve të tepërta në objekt. Orari nominal mesatar për punimet e gerrimit në trupin e rrugës dhe në mabientin përreth është rreth 0.1 op/m³. Referuar grafikut të punimeve që paarshikon afatin me 23 ditë pune. Makineritë që nevojiten janë 1 ekskavator me goma, 1 fadromë me goma , 3 kamion etj.

c) Punime per trupin e rrugës.

- **Volumi i punimeve** **33,006 m².**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **4,884 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.148 op/m³**

Keto punime perfshijne rikonstruksionin e shtresave ekzistuese dhe hedhjen e materialit te ri sipas zerave te percaktuar ne preventiv. Orari nominal mesatar per punimet ne trupin e rruges eshte rreth 0.148 ore/m³. Referuar grafikut qe parashikon afatin 36 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 5 specialiste dhe 10 puntore. Makinerite qe nevojiten jane:, 1 asfaltoshtruese, 1 autobitumatrice, 1 autobot uji, 1 grejder, 1 rrul me vibrim, 2 kamion, 1 miniekskavator.

d) Punime betoni.

- **Volumi i punimeve** **20 m³.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **129 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.155 op/m³.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te betonit me pjerrresi te caktuar sipas specifikimit ne projekt per kullimin e ujerave te bardha te disiplinuar. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 7 dite pune. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamoci ne 3.5 ton, 2 betoniere 0.5 m³,

e) Punime per trotuaret

- **Volumi i punimeve** **257 m².**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **120.1 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **2.14 op/m².**

Keto punime perfshijne vendosjen e pllakave te trotuarit sipas percaktimeve ne projekt. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 6 dite pune. Per realizimin e ketyre

punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton.

f) Punime per kanalizimet e ujerave.

- **Volumi i punimeve** .
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 240 op.
- **Norma mesatare e punimeve** 1.2 op/m3.

Keto punime perfshijne vendosjen e tubacionit per rrjetin ekanalizimit te ujerave te zeza sipas percaktimeve ne projekt, hedhjen e shtresave perkatese si zhavorr per bazamentin dhe ndertimi i pusetave te kontrollit sipas dimensioneve perkatese. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 30 dite pune. Per realizimin e ketyre punimeve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 4 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 ekskavator, 1 autovinc deri ne 2.5 ton, 1 kamion.

g) Punime per muret mbajtese.

- **Volumi i punimeve** .
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 112 op.
- **Norma mesatare e punimeve** /op.

Keto punime perfshijne ndertimin e mureve mbajtese ne zonat me rrezikshmeri rreshqitje. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 14 dite pune. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 2 betoniere betoni, 1 vibrator betoni, 1 autobot uji.

h) Punime elektrike.

- **Volumi i punimeve**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 122 op.
- **Norma mesatare e punimeve** m2/op.

Keto punime perfshijne shtrimin e linjave elektrike dhe vendosjen e ndricuesve sipas percaktimeve ne projekt me ndricues LED dhe panele fotovoltaike. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 14 dite pune. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 1 specialiste dhe 3 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 autovinc deri ne 2.5 ton

i) Punime per demobilizimin e kantierit

Per demobilizimin e kantierit duke qene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (minikantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetëve të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.11. Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndermarjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin të punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbeshtetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP-së, për zërat në preventive që mund të jetë paraqitur marke/brand, origjinë apo prodhim specifik, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Specifikimet teknike janë bere për permbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor. Materialet i kanë specifikimet e tyre cilësore dhe sasiore sipas zerave të secilit në preventive dhe në specifikimet teknike, hartuar për çdo zë punimi sipas preventivit të punimeve, bashkelidhur dokumentave të tenderit.

Të gjitha zërat e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga **Drejtoria E Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **19/09/2024, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: "**Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re**".

NJËSIA E PROKURIMIT :